V E N D I M
Nr. 519, datë 24.10. 2002

PËR HAPJEN E SHKOLLAVE PASUNIVERSITARE PRANË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, UNIVERSITETIT POLITEKNIK, UNIVERSITETIT BUJQËSOR DHE AKADEMISË SË ARTEVE DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË KËTO SHKOLLA PASUNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 paragrafi i shtatë 24, 37 dhe 38 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e shkollave pasuniversitare (SHPU) pranë shkollave të larta universitare, si më poshtë vijon:

Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, pranë Universitetit të Tiranës, në këtë degë:

- SHPU në fizikë, drejtimi spektrometri.
- Në fakultetet pranë Universitetit Politeknik, Tiranë, në këto degë:

a) Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave :

- SHPU në gjeoshkenca dhe mjedisi, drejtimi gjeologji-gjeofizikë.

b) Në fakultetin e Inxhinierisë Mekanike:

- SHPU në termoenergjitikë;
- SHPU në prodhim e menaxhim.

c) Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike:

- SHPU në telekomunikacion dhe inxhinieri informacioni;
- SHPU në inxhinieri kompjuteri;
- SHPU në inxhinieri sistemesh kontrolli.
- Në Departamentin e Matematikës dhe të Informatikës, pranë Rektoratit, në degën:
- SHPU në matematikë të zbatuar.
- Në Fakultetin e Bujqësisë, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, në këtë degë:
- SHPU në drejtim bujqësor dhe studime europiane.
- Pranë Akademisë së Arteve, Tiranë, në këtë degë:
- SHPU në muzikologji, drejtimet etnomuzikologji, histori muzike, teori muzike, kritikë dhe estetikë muzikore.

1. Shpenzimet për funksionimin e SHPU-ve të mbulohen nga tarifat e shkollimit, buxheti i arsimit dhe nga të ardhurat e tjera, të krijuara sipas akteve, ligjore e nënligjore, në fuqi.

2. SHPU-të të funksionojnë me korrespodencë, përveç rasteve kur shkolla e lartë universitare i mbulon shpenzimet pa shtesë fondesh buxhetore.

3. Tarifat e shkollimit për SHPU-të të jenë:

- Për kandidatët nga stafi akademik, efektivi i shkollave të larta publike dhe për punonjësit kërkimorë të institucioneve të Akademisë së Shkencave:
- 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë për SHPU-të në shkencat shoqërore;
- 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për SHPU të , në shkencat natyrore, teknike dhe të aplikuara;
- Për kandidatët e tjerë të sistemit buxhetor:
- 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për SHPU-të në shkencat shoqërore;
- 40 000 (dyzet mijë) lekë për SHPU-të në shkencat natyrore, teknike dhe të aplikuara.
- Për kandidatët jashtë sistemit buxhetor:
- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për SHPU-të, në shkencat shoqërore;
- 55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë) lekë për SHPU-të në shkencat natyrore, teknike dhe të aplikuara.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendmi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano